



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3275 prot

Roskovec, më 30.04.2026

VENDIM

NR 74.DATË 30.04 2026

PËR
ANËTARËSIMIN E BASHKISË ROSKOVEC NË SHOQATËN E QYTETEVE DHE
RAJONEVE PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË BURIMEVE
(ASSOCIATION OF CITIES AND REGIONS FOR SUSTAINABLE RESOURCE
MANAGEMENT/ ACR+)

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.5 dhe 1.6, nenit 23, nenit 54, shkronja “d” dhe “dh”, të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 10 të ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore” të Ligjit Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.71 datë 24.12.2025, “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026” të miratuar nga Prefektura e Qarkut Fier me shkresë Nr.139/1 prot, datë 06.01.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,”; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1-Të miratojë anëtarësimin e Bashkisë Roskovec në “Shoqatën e qyteteve dhe rajoneve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve” Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management (ACR+) duke i dhënë mundësinë të jetë pjesëmarrëse në projekte dhe programe ndërkombëtare në një rrjet që promovon menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe bashkëpunimin ndërmjet qyteteve dhe rajoneve.

2-Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për nënshkrimin e formularit të anëtarësimit në “Shoqatën e qyteteve dhe rajoneve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve” Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management (ACR+).

3-Miratimin e pagesës së kuotës së anëtarësimit përfshirë dhe komisionin bankar në vlerën **78,000 lekë (shtatëdhjetë e tetë mijë lekë)** e cila do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec i miratuar me Vendim Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.71 datë 24.12.2025“Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026” dhe miratuar nga Prefektura e Qarkut Fier me shkresë Nr.139/1 prot, datë 06.01.2026.

4-Ngarkohet Sektori i Integrimit Europian, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

5-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

